




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



**PROCESVERBAL NGA DËGJIMET
BUXHETORE
PROCESVEBAL NGA TAKIMI ME
RININË, GRATË, PENSIONISTËT
DHE KOMUNITETET PAKICË**

21.05.2026

Procesvebal nga takimi me rininë, gratë, pensionistët dhe komunitetet pakicë.

Blertë Gashi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm, drejtor për Buxhet dhe Financa, anëtarë të grupit punues dhe ju qytetarë të pranishëm. Ky është cikli i parë i dëgjimeve buxhetore për përgatitjen e kornizës afatmesme buxhetore dhe takimi i tretë me radhë. Ky proces shënon fillimin e konsultimeve publike dhe bashkëpunimit institucional për planifikimin e prioriteteve dhe projekteve që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Qëllimi i dëgjimeve është që përmes diskutimeve tuaja të identifikohen prioritetet kryesore për investime dhe shërbime. Çdo propozim dhe çdo kërkesë e juaja do të trajtohet nga grupi punues gjatë hartimit të dokumenteve buxhetore.

Afrim Limani: Të nderuar pjesëmarrës! Më lejoni që në cilësinë e drejtorit për Buxhet dhe Financa t'ju shpjegojë buxhetin komunal për vitin 2027. Më datë 16 maj ka ardhur Qarkorja e Parë Buxhetore, që është dokument i rëndësishëm financiar i përcaktuar me Ligj të Financave Publike dhe Përgjegjësisive dhe e përcakton hisen buxhetore për çdo komunë të Republikës së Kosovës. Sipas këtij dokumenti, buxheti i komunës së Rahovecit për vitin 2027 është 21.704.000€ dhe ndahet sipas programeve. Në administratë: 9.946.000 dhe kur e bëjmë një krahasim me vitin aktual, kemi rritje të buxhetit prej 778.000€. Në arsim: 634.305 dhe kur bëjmë krahasim me vitin 2026, kemi një zvogëlim prej 660.000. Në shëndetës: 2.323.000 dhe kur bëjmë krahasim me vitin aktual, kemi një rënie prej 36.000. E falënderoj ekipin tim të financave, që brenda një afati shumë të shkurtër kemi bërë një punë shumë intenzive. Në kategori ekonomike, përafërisht buxheti duhet të jetë kështu: Pozicioni i pagave: 12.919.000€, mallra dhe shërbime 2.821.000, shpenzime komunal 440.00, subvencione 1.000.000 dhe investime kapitale 4.523.000, 374.000 euro më pak në vitin 2027 se sa në vitin 2026. Të nderuar pjesëmarrës, si rezultat i kontratës kolektive jemi në një krizë financiare, krejt kjo si pasojë e kontratës kolektive, e cila deri më tani i ka tërhequr 3.5 milionë. Buxheti i arsimit gjithashtu ka ndikuar që ulje të buxhetit, sepse mungesa e nxënësve llogaritet sipas formulës. Drejtpërdrejt në zvogëlimin e buxhetit është edhe numri më i vogël i popullsisë, pra jemi 14.000 banorë më pak se sa në regjistrimin e parafundit. Ju ftoj t'i paraqitni kërkesat e juaja për vitin 2027.

Kujtim Popaj: Përshëndetje për të gjithë pjesëmarrësit! Kam qenë edhe kryesues i kuvendit në të kaluarën dhe rastësisht e pashë lajmërimin në fejsbuk dhe vendosa të marrë pjesë. Mirë është që pjesëmarrja të jetë më e madhe në këto dëgjime buxhetore, sepse janë mjaft të rëndësishme. Po e shoh që ka ulje të buxhetit për shkak të numrit të banorëve dhe respektivisht për shkak të numrit më të vogël të nxënësve dhe arsyeve të tjera. Qëllimi kryesor, sipas mendimit tim është që t'ia qëllojmë me projekte. Drejtor, ku kemi mbetur me projekte të kaluara, a do të vazhdojnë të njëjtat? Në Fortesë nuk është investuar që një kohë të gjatë, Kemij nevojë për kanalitim, Kemij probleme me vlrshitime, dukuri që ndodh shpesh pas reshjeve të l shiut. Cilat kanë qenë projektet që janë planifikuar dhe nuk janë realizuar.

Afrim Limani: Kujtim, faleminderit për pjesëmarrjen! Sivjet, rreth 3.5 milionë euro thesari i ka tërhequr për shkak të kontratës kolektive. Vitin e kaluar e kemi pasur problemin e njëjtë. Projektet janë realituar rreth 40/50%. Ndërtimi i shkollës “Hamëz Thaqi” në Xërxë dhe shkolla në Ratkoc, rreth 600.000 euro janë tërhequr që kanë qenë të planifikuara për to. Tani, njëra shkollë është në përfundim e sipër, por shkolla “Hamëz Thaqi” ka ngelur ende. E kemi edhe një mori projektesh, por për shkak të kësaj gjendjeje jem në vështirësi të madhe. Si Asociacion i Komunave e kemi bërë një padi në gjykatën komerciale dhe presim vendim pro nesh. Gjithashtu, qeveria me një vendim mund t’i mbulojë këto kontrata. Presim...

Lendrit Qeli: Përshëndetje për të gjithë! Dua ta pyes drejtorin një informacion më të gjerë rreth mjeteve për Hoçën së Madhe? A është i paraparë ndonjë projekt në vendbanime të komuniteteve? Një kërkesë: Këto 25.000 që i kemi si zyre, a mund të shndërrohen në subvencione? Duke e ditur që kjo zyrë ka plane të ndryshme të veprimit, ndoshta kjo pjesa e subvencioneve do të na konvenonte më shumë për mbulimin e gjërave më shumë.

Afrim Limani: E para, buxheti për Hoçën e Madhe është 39.000 euro me një rritje simbolike. Këto mjete shfrytëzohen kryesisht në pozicionin e pagave. Sivjet, si zyrë i keni të buxhetuara 30.000euro dhe këto mjete varet nga ju, sipas kërkesave të komunitetit kah t’i orientoni. Subvencionet i kemi të buxhetuara në 5 drejtori, varësisht prej nevojave të drejtorive përkatëse.

Qemajl Krasniqi: Një shqetësim: duke pasur pasrasysh kontratën kolektive dhe projektet që kanë mbetur në gjysmë, por në planifikimin e buxhetit e dimë si shkon. E kam një kërkesë: A është planifikuar ndonjë rritje e buxhetit për kulturën? Do të duhej të investohen në kulturë, sepse jemi në një periudhë digjitale, a ka diçka konkrete në këtë çështje?

Afrim Limani: Kondideroj që kryetari i ka dhënë mjaft prioritet kulturës, me aq mundësi që i kemi. Janë 120.000 euro subvencione vetëm për kulturë dhe kryetari për çdo vit bën rritje në këtë kategori. Ka investime edhe në sport dhe aktivitete të tjera. E konsideroj që janë të mjaftueshme për mbulimin e kërkesave të drejtorisë përkatëse.

Muharrem Morina: Duke u bazuar në rëndësinë e rinisë në zhvillim social, a keni paraparë ndonjë kod buxhetor për sektorin e rinisë, të veçantë këtë kod buxhetor?

Afrim Limani: Qarkorja ka ardhur që dy ditë dhe nuk është e lehtë që kaq shpejt të bëjmë diçka. Paraprakisht, duhet ta bëjmë një analizë të thellë për të bërë veprime të tilla. Bashkërisht me juve do të bëjmë diçka.

Kujtim Popaj: Ky është mandati i tretë i qeverisjes suaj. Cilat janë kriteret që i përdornij si qeveri për projektet që doni t’i realizoni?

Afrim Limani: Nuk e kemi ndonjë kriter të shkuar, mirëpo ideologjia dhe qëllimi është që asnjë vendbanim mos ta lëmë pa projekt. Në çdo vendbanim të komunës së Rahovecit ne realizojmë dëgjime buxhetore dhe në bazë të kërkesave i realizojmë projektet.

Bleritë Gashi: Nëse nuk ka pyetje dikush tjetër, ju falënderojmë për kontributin.

Procesmbajtës: Albion Krasniqi